



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

Në mbështetje të Vendimit Nr.04/181, marrë me datë me 02/04/2014 nga Qeveria e Republikës së Kosovës mbi themelimin Këshillit për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017, Këshilli në mbledhjen e mbajtur më... miraton:

Termet e referencës (Rregullat e punës)

Qëllimi

- 1) Themelimi dhe puna e Këshillit bazohet mbi parimet e partneritetit, bashkëpunimit dhe mundësive të barabarta si dhe trajtimit të barabartë të të gjithë anëtarëve të Këshillit.
- 2) Këshillin për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile është krijuar për të siguruar, koordinuar dhe monitoruar zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie 2013 -2015.
- 3) Me këto terma të referencës rregullohet fushëveprimi dhe përbërja e Këshillit për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile (në tekstin e mëtejme: Këshilli) për të siguruar, koordinuar dhe monitoruar zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie 2013 -2015.
- 4) Këshilli do të shërbej edhe si strukturë mbështetëse që do të ndihmoj Zyrën e Kryeministrit/Zyrën për Qeverisje të Mirë në zhvillimet dhe mbarë procesin e bashkëpunimit qeveri- shoqëri civile.

Detyrat e Këshillit

Këshilli është përgjegjës për zbatimin e detyrave në vijim:

- 1) Monitorimin, vlerësimin dhe raportimin mbi zbatimin e Strategjisë;
- 2) Diskutimin dhe propozimin e zgjidhjeve për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Strategjisë;

- 3) Diskutimin dhe propozimin e zgjidhjeve për çështje të tjera që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e Qeverisë me shoqërinë civile e që nuk janë të përcaktuara në Strategji;
- 4) Këshilli mund të propozojë masa shtesë për zbatimin e Strategjisë;
- 5) Të propozojë marrjen e masave për zbatimin e politikave publike që synojnë nxitjen e zhvillimit të OShC-ve,
- 6) Të inicioj krijimin e legjislacionit që synon nxitjen e zhvillimit të OShC-ve;
- 7) Të marrë parasysh propozimet dhe nismat e paraqitura nga OShC-të;
- 8) Këshilli është përgjegjës për procesin e rishikimit të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile;
- 9) Për zbatimin e detyrave të tij, Këshilli duhet të bashkëpunojë edhe me institucionet e tjera publike si dhe me organizatat e shoqërisë civile.

Monitorimi i zbatimi të Strategjisë

- 1) Për mbledhjen e të dhënave nga organet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë, Këshilli aprovon udhëzimet për raportim, të hartuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë;
- 2) Për një monitorim krahasues dhe transparent të zbatimit të Strategjisë, Këshilli krijon një formë të matricës, në të cilën organet përgjegjëse raportojnë në mënyrë periodike për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë e të cilat do të përditësohen për çdo seancë;
- 3) Periudha e raportimit për zbatimin e Strategjisë nga organet përgjegjëse para Këshillit do të jetë çdo gjashtë muaj;
- 4) Mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, Këshilli përgatitë rekomandime për zbatimin e mëtejshëm, përshtatjen e nevojshme të Strategjisë dhe mekanizmave të saj, si dhe këshillon Zyrën për Qeverisje të Mirë për përgatitjen e raporteve për zbatimin e Strategjisë;
- 5) Për lehtësim të procesit të sigurimit të zbatimit të Strategjisë Këshilli do të krijoj grupe pune për secilën nga Objektivat Strategjike;
- 6) Do të krijohen katër (4) grupe të punës, konkretisht për secilën Objektivë të Strategjisë do të krijohet një grup Punues;
- 7) Si mbështetje në punën e tij Këshilli bashkëpunon ngushtë me Grupet e themeluara për secilën nga objektivat strategjike të Planit.
- 8) Për secilin grup do të emrohet një koordinatorë i cili e udhëheqë dhe koordinon punën e grupit të punës. Koordinatorët e grupeve të punës duhet të jenë anëtarë të Këshillit;
- 9) Këshilli do të marr në konsideratë të gjitha materialet, të dhënat dhe propozimet e paraqitura nga grupet dhe parimisht iu përgjigjet të gjitha iniciativave të propozuara nga këto grupe;

- 10) Grupet e punës në përbërjen e tyre do të përfshijnë anëtarë të Këshillit, përfaqësuese të institucioneve publike dhe OSHC-ve tjera fushëveprimtaria e të cilave përkon me objektivat përkatëse strategjike;
- 11) Thirrja e takimeve të grupeve të punës bëhet nga koordinatorët e grupeve ose Sekretaria e Këshillit.

PËRBËRJA E KËSHILLIT

(Anëtarët e Këshillit)

- 1) Këshilli udhëhiqet nga:

1.1. z. Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit (Kryesues)

1.2. z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë, zv.kryesues

1.3. Udhëhesi i Civikosit (bashkëkryesues) –

1.4. Në rast të mungesës, bashkëkryesuesi nga radhët e CiviKos ka të drejtë që të delegojë përgjegjësinë e bashkëkryesimit të takimit përkatës te njëri nga anëtarët e Këshillit nga shoqëria civile.

- 2) Këshilli ka 29 anëtarë, 14 përfaqësues të Qeverisë Republikës së Kosovës dhe 15 përfaqësues të shoqërisë civile. Përfaqësuesit tjerë të Qeverisë emërohen nga institucionet në vijim, të cilat përfaqësohen në nivel të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe drejtorëve përgjegjës:

2.1. Ministria e Administratës Publike, Sekretari i Përgjithshëm (një anëtar);

2.2. Ministria e Integritetit Evropian, Sekretari i Përgjithshëm (një anëtar);

2.3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Sekretari i Përgjithshëm (një anëtar);

2.4. Ministria e Financave, Sekretari i Përgjithshëm (një anëtar);

2.5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sekretari i Përgjithshëm (një anëtar);

2.6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Sekretari i Përgjithshëm, (një anëtar);

2.7. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Sekretari i Përgjithshëm, (një anëtar);

2.8. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, (një anëtar);

2.9. Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, (një anëtar);

2.10. Zyra për Planifikim Strategjik/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, (një anëtar);

2.11. Zyra për Komunikim me Publikun, Drejtori, (një anëtar);

2.12. Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Drejtori, (një anëtar);

2.13. Zyra Administrative/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, (një anëtar);

- 3) Nga 15 përfaqësues të shoqërisë civile, 1 anëtar emërohet drejtëpërdrejtë nga Platforma CiviKos dhe 14 anëtar tjerë të zgjedhur nga vetë organizatat e shoqërisë civile në bazë të një procedure demokratike, të hapur dhe transparente.
- 4) Anëtarët vëzhgues – me ftesë të përfaqësuesve të Këshillit qoftë nga institucionet qoftë nga organizatat e shoqërisë civile Sekretariati i Këshillit obligohet që të ftoj organizatat qoftë vendore ose edhe partnerët ndërkombetare në cilësinë e pjesëmarrësve përkrahës dhe partner të Këshillit.
- 5) Angazhimi i anëtarëve të Këshillit, anëtarëve të Grupeve të Punës dhe të tjerëve që përfshihen në punën e Këshillit bëhet në baza vullnetare, pa ndonjë kompenzim financiar.

Sekretariati i Këshillit

- 1) ZKM/ZQM do të shërbejë si Sekretarit dhe do të jetë organi përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë qeveritare dhe Planit të Veprimit për bashkëpunim me shoqërinë civile.
- 2) Të gjitha detyrat administrative dhe teknike për një punë pa pengesa të Këshillit ofrohen nga Zyra e Kryeministrit / Zyrapër Qeverisje të Mirë.
- 3) ZKM/ZQM obligohet që në baza vjetore të publikoj Raportin për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
- 4) Përveç raporteve të përgadituar nga Zyra për Qeverisje të Mirë Këshilli do të marrë parasyshë dhe do të diskutojë edhe raportet tjera të monitorimit paralel që mund të prodhohen nga Platforma CiviKos dhe OSHC-të tjera.
- 5) Për mbarëvajtjen me sukses të punës këtij Këshilli, Sekretariati do të mbështetet nga Zyra e Kryeministrit qoftë financiarisht qoftë me resurse njerëzore.

PUNA E KËSHILLIT

Seancat e Këshillit

- 1) Këshilli mbledhet në seancë së paku dy herë në vit për të vlerësuar progresin e zbatimit të Strategjisë mbi bazën e të dhënave të mbledhura dhe raporteve të përgatitura nga grupet e punës.
- 2) Ftesa për seancë, së bashku me rendin e ditës së seancës dhe materialet për diskutim duhet të dërgohen tek anëtarët nga Zyra për Qeverisje të Mirë të paktën katërmbëdhjetë 14 ditë përpara seancës.
- 3) Këshilli pa praninë e antarëve shumicë nuk mund të mbajë takimet, gjithmonë nevojitet kuorum i mjaftueshëm i shumicës së antarëve të Këshillit si nga ana e institucioneve ashtu edhe kuorumi nga ana e anëtarëve shumicë të shoqërisë civile.

- 4) Mundësi për të ftuar takime të jashtëzakonshme të Këshillit kanë edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, qoftë nëpërmjet bashkë-kryesuesit nga shoqëria civile ose edhe nga shumica e anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile.

Procesverbalet e seancave

- 1) Procesverbali përgatitet për çdo seancë nga Zyra e Kryeministrit/ Zyrapër Qeverisje të Mirë dhe nënshkruhet nga bashkë-kryesuesit në seancën e radhës.
- 2) Procesverbali duhet të përmbajë datën dhe vendin e seancës, rendin e ditës, përmbledhjen e diskutimeve, vendimet, emrat e anëtarëve pjesëmarrës dhe zëvendësve.
- 3) Draft-procesverbali i dërgohet anëtarëve të Këshillit, më së voni një javë pas seancës së Këshillit.

Vendim-marrja

- 1) Vendim- marrja në Këshill gjithmonë do synohet të arrihet me konsensus.
- 2) Në rast të mungesës së konsensusit vendimet hidhen në votim.
- 3) Këshilli merr vendim me shumicën e të gjithë anëtarëve që marrin pjesë në takimet e Këshillit.
- 4) Në rastin e një vendimi me vota të barabarta, vota e bashkë-kryesuesit, përfaqësuesit të shoqërisë civile, është vendimtare.

Publikimi i punës së Këshillit

- 1) Të gjitha aktivitetet e Këshillit do të publikohen edhe në një link të veçantë në web faqen zyrtare të ZKM/ ZQM.
- 2) Të gjitha ftesat, agjendat, procesverbalet dhe materialet për seancat publikohen edhe në web faqe.
- 3) Me qëllim të monitorimit të vazhdueshëm të zhvillimeve, matrica e zhvilluar në të cilën organet përgjegjëse raportojnë në mënyrë periodike për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë e të cilat do të përditësohen për çdo seancë të Këshillit do publikohet në internet.